



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 12670 prot.

Tiranë, më 13.7.2021

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi

**DREJTORIVE NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË DOGANAVE
DEGËVE DOGANORE**

Për publikim: **DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE
INTEGRIMIT EUROPIAN**

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të Ligjit 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 921 datë 29.12.2014 “Për personelin e Administratës Doganore”, i ndryshuar, Ligjit 25/2019 “Për Organizimin dhe Funkcionin e Policë Gjyqësore”, shpall konkurimin e hapur për pozicionin:

Oficer i Policisë Gjyqësore, Sektori Task Forca, Drejtoria e Hetimit, pranë Departamentit Operativ Hetimor, Kategoria C1, Kategoria e Pagës III-b, 1 (një) vend pune

Kandidatët që do të aplikojnë duhet të plotësojnë këto kritere:

1. Të kenë shtetësi shqiptare
2. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar
3. Të gëzojnë shëndet të mirë për të kryer detyrat e tyre
4. Të mos kenë qenë të dënuar me vendim penal të formës së prerë
5. Të mos kenë qenë larguar më parë nga administrata shtetërore për thyerje të disiplinës ose shkelje të tjera serioze
6. Të zotërojnë diplomë të nivelit Master Profesional në shkencat Juridike, Ekonomike, Natyrore ose të lidhura me Sigurine dhe Hetimin.
7. Eksperiencë pune të paktën 1 vitë
8. Të ketë njohuri të paktën të një gjuhe të huaj.

Avantazhe:

Të ketë njohuri në fushën doganore.

Përshkrim përgjithësues për pozicionin:

Specialist i Task Forcës, (OPGJ) përgjigjet tek Përgjegjësi i Sektorit të Task Forcës për dosjen në lidhje me shkeljen e verifikuar dhe të hetuar nga ana e tij, në përputhje me kërkesat e legjislacionit doganor dhe penal duke redaktuar edhe relacionin përfundimtar për çështjen

Zhvillimiin e hetimeve të plota, objektive dhe të gjithanshme, në përputhje me procedurat që përcakton Kodi Doganor, Kodi i Procedurave Administrative, Kodi Penal dhe Kodi i Proedurës Penale.

Hetuesit e inkuadruar pranë njësive të përbashkëta hetimore (O.P.Gj) janë të detyruar të informojnë me shkrim, një herë në 3 muaj Drejtorin e Drejtorisë së Hetimit për ngarkesën në punë, ecurinë, deri ne perfundimin e hetimeve paraprake lidhur me çështjet e kallëzuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, objekt i punës së tyre.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Kërkesë për marrje pjesë në konkurim
2. Curriculum Vitae
3. Fotokopje e Diplomës dhe Lista e Notave të noterizuara (*Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit*)
4. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore /dëshmi penalteti
5. Vërtetim nga Gjykata
6. Vërtetim nga Prokuroria
7. Vërtetim nga Tatim-Taksat
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore
9. Fotokopje të letërnjoftimit (ID)
10. Fotokopje të librezës së punës;.
11. Letër reference dhënë nga eprori direkt i pozicionit të fundit të punës
12. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më sipër.

Procedura e konkurimit do të zhvillohet në dy faza.

Në fazën parakualifikuese kandidatët do të vlerësohen nga dokumentacioni i paraqitur nëse plotësohen kërkesat për konkurim. Aplikantët të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e përcaktuara skualifikohen.

Faza e dytë do të vijojë me kandidatët e kualifikuar për të marrë pjesë në intervistë. Rezultatet e intervistës bazohen në:

- a) Pervojën
- b) Kualifikimin
- c) Aftësitë

Kandidatët e përzgjedhur duhet të marrin mbi 70 pikë në intervistë.

Data e intervistës do të caktohet në një njoftim të dytë.

Rezultatet e konkurimit

Lista me kandidatët fitues, do të shpallet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 23.07.2021, ora 16:00 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore/ Zyra e Sekretari/Protokollit.

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Genti Gazheli

